- y. Fondi 4, I-Shtabi, Dosje nr. 35, Buletine të Drejtorisë së Sigurimit mbi komentet dhe parullat e elementit armik rreth situatës në vendin tonë para e pas plenumit VIII dhe tradhtisë së jugosllavëve, me nr. total faqesh të digjitalizuara 15;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Simon Mirakaj

Vendim nr. 478, datë 18.07.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 36 e vijues të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I

1. Të vërë në dispozicion të shtetasit Gj. E. dokumentet si më poshtë:
 - a. Dosje nr. 254, dega IV, fashikull nr. 1, internim-dëbime, deklasifikuar me vendim nr. 1, datë 22.01.2019, me nr. total faqesh të digjitalizuara 206;
 - b. Dosje nr. 254, dega IV, fashikull nr. 2, internim-dëbime, deklasifikuar me vendim nr. 1, datë 22.01.2019, me nr. total faqesh të digjitalizuara 167;
 - c. Dosje nr. 254, dega IV, fashikull nr. 3, internim-dëbime, deklasifikuar me vendim nr. 1, datë 22.01.2019, me nr. total faqesh të digjitalizuara 265.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Simon Mirakaj

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 14, datë 09.07.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 14, datë 09.07.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. **Dosje përpunimi nr. 2427**, kategoria 2/B, në ngarkim të **I. H. N.** me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. **Dosje formulare nr. 849**, kategoria 2/B, në ngarkim të **K. I. D.** me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
3. **Dosje formulare nr. 332**, kategoria 2/A, në ngarkim të **I. Xh. V.** me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. **Dosje përpunimi nr. 584**, kategoria 2/B, në ngarkim të **N. (N.) Rr. A.** me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. **Dosje përpunimi nr. 2727**, kategoria 2/B, në ngarkim të **Z. (Z.) Rr. A.** me 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. **Dosje formulare nr. 103**, kategoria 2/A, në ngarkim të **S. S.(S.) B.** me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. **Dosje me materiale gjyqësore nr. 206**, në ngarkim të **S. S.(S.) B.** me 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
8. **Dosje formulare nr. 2919**, kategoria 2/A, në ngarkim të **M.(M.) I. P.** me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. **Fashikull nr. 2946**, në ngarkim të **E. I. H.** me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. **Fashikull nr. 5572**, në ngarkim të **M. K.** me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
11. **Fashikull nr. 4147**, në ngarkim të **J. G.** me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

12. **Dosje formulare nr. 1497**, kategoria 2/A, në ngarkim të **A. Xh. L.** me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
13. **Dosje përpunimi nr. 4360**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Q. Y. K.**, tre volume me 565 (pesëqind e gjatëdhjetë e pesë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
14. **Dosje formulare nr. 3707**, kategoria 2/B, në ngarkim të **T. L. D.** me dy volume me 232 (dyqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
15. **Dosje formulare nr. 1391**, kategoria 2/A, në ngarkim të **N. (N.) R. M.(o)** me 390 (treqind e nëntëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
16. **Dosje formulare nr. 1923**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Th. (Dh.) I. L.** me 328 (treqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
17. **Fashikull nr. 9**, në ngarkim të **L. R. O.** me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
18. **Dosje formulare nr. 994**, kategoria 2/A, në ngarkim të **H. Xh. S.** me 46 (dyzetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
19. **Dosje përpunimi nr. 86**, kategoria 2/B, në ngarkim të **R. H. M.**, me 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
20. **Dosje përpunimi nr. 12.635**, kategoria 2/A, në ngarkim të **E. I. O.**, me 277 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
21. **Dosje agjenturiale “Bataku” nr. 760**, në ngarkim të **E. I. O.**, me dy volume me 369 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
22. **Dosje formulare nr. 1119**, kategoria 2/B, në ngarkim të **A. L. B.** me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë + 35(tridhjetë e pesë) në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
23. **Dosje formulare nr. 686**, kategoria 2/A, në ngarkim të **M. Gj. D.**, tre volume me 588 (pesëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë në total + 62 fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
24. **Dosje formulare nr. 5574** në ngarkim të **R. P. P.**, me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1976-1978.
25. **Dosje operative nr. 10.728** në ngarkim të **Rr. Q. A.**, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 15, datë 08.08.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë

15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 15, datë 08.08.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. **Dosje formulare nr. 35.806**, kategoria 2/A, në ngarkim të **K. H. D.**, me 24 volume, në total me 5281 (pesëmijë e dyqind e tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. **Dosje përpunimi nr. 3366**, kategoria 2/A, në ngarkim të **M. J. Gj.**, me 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. **Dosje formulare nr. 6033**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Sh. Gj. A.**, me 81 (tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. **Dosje formulare nr. 4783**, kategoria 2/A, në ngarkim të **R. Gj. A.**, me 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. **Dosje përpunimi me 2 volume nr. 3367 dhe 3367/1**, kategoria 2/B, në ngarkim të **T. S. H.**, me 432 (katërqind e tridhjetë e dy) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. **Dosje formulare nr. 38**, kategoria 2/B, në ngarkim të **M. H. D.**, me 440 (katërqind e dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. **Dosje përpunimi nr. 4967**, kategoria 2/B, në ngarkim të **P. A. S.**, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
8. **Dosje formulare nr. 3150**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Th. V. N.** me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
9. **Dosje agjenturore nr. 755**, pseudonimi “Mustaqja” në ngarkim të studentëve kosovarë **Sh. K., I. Z. dhe P. Z.** dhe të emigrantëve **D. M., Z. N., N. B. dhe L. K.** me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
10. **Dosje përpunimi nr. 3367**, kategoria 2/B, në ngarkim të **P. A. S.**, me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
11. **Dosje përpunimi nr. 6268**, kategoria 2/B, në ngarkim të **B. S. K.**, me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
12. **Dosje përpunimi nr. 5998**, kategoria 2/A, në ngarkim të **A. V. L.**, me 127 (njëqind e njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
13. **Dosje formulare nr. 1275** kategoria 2/B, në ngarkim të **N. V. C.**, me 40 (dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

14. **Dosje formulare nr. 2139** kategoria 2/A, në ngarkim të **Sh. R. G.**, me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
15. **Dosje përpunimi nr. 4196** kategoria 2/B, në ngarkim të **K. K. A.**, me 99 (nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
16. **Dosje formulare nr. 4454**, kategoria 2/B, në ngarkim të **Z. T. L.**, me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
17. **Dosje formulare nr. 2767**, kategoria 2/B, në ngarkim të **F. L. Q.**, me 150 (njëqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
18. **Dosje përpunimi nr. 6064**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Sh. H. Gj.**, me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
19. **Dosje formulare nr. 2460**, kategoria 2/B, në ngarkim të **S. Z. D.**, me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
20. **Dosje formulare nr. 2141**, kategoria 2/B, në ngarkim të **V. A. T. (H.)** me 104 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
21. **Dosje përpunimi nr. 6153**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Sh. M. H. (H.)** me 110 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
22. **Dosje përpunimi nr. 760/1**, kategoria 2/A, në ngarkim të **L. P. M.** me 147 (njëqind e dyzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
23. **Dosje përpunimi nr. 5022**, kategoria 2/A, në ngarkim të **S. H. A.** me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
24. **Dosje përpunimi nr. 4866**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Ll. K. B.** me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
25. **Dosje përpunimi nr. 4962**, kategoria 2/A, në ngarkim të **Z. I. B.** me 6 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
26. **Dosje personale dhe pune nr. 10 266** me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, në ngarkim të **A. Sh.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
27. **Dosje personale dhe pune nr. 6876** me 29 (njëzet e nëntë) fletë, në ngarkim të **N. E. Z.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
28. **Dosje personale dhe pune nr. 8952** me 38 (tridhjetë e tetë) fletë, në ngarkim të **N. B. K..** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
29. **Dosje personale nr. 8006** me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, në ngarkim të **Dh. J. T.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
30. **Dosje personale dhe pune nr. 6672** me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, në ngarkim të **M. F. J..** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
31. **Dosje personale dhe pune nr. 10.223** me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, në ngarkim të **Z. N. S.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
32. **Dosje personale nr. 10.047** me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë, në ngarkim të **D. S. H.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
33. **Dosje personale nr. 7065** me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë, në ngarkim të **S. S. I.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

34. **Dosje personale nr. 7178** me 24 (njëzet e katër) fletë, në ngarkim të **B. H. D.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
35. **Dosje personale nr. 10.130** me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë, në ngarkim të **N. I. M.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
36. **Dosje personale dhe pune me 4 volume nr. 2839, 2839/1, 2839/2 dhe 2839/3** me 519 (pesëqind e nëntëmbëdhjetë) fletë në total, në ngarkim të **R. R. D.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
37. **Dosje personale dhe pune nr. 6223** me 355 (treqind e pesëdhjetë e pesë) fletë, në ngarkim të **H. B. B.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
38. **Dosje pune nr. 2138** me 7 (shtatë) fletë në total, në ngarkim të **N. S. Gj.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
39. **Fashikull nr. 1957/50**, në ngarkim të **I. E. C.** me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
40. **Regjistër i personave të marrë në vëzhgim**, model 18, nr. 23, datë 21.06.1988, 198 fletë, deklasifikim i pjesshëm në fletën 1, me numër rendor 6, 8, 9, 10, 11 dhe 14. Në fletën nr. 2, deklasifikim i pjesshëm me numër rendor 18, 19, 21, 22 dhe 23.
41. **Regjistër alfabetik për këshillime dhe demaskime**, model 7, nr. 52, datë 11.05.1987 me 99 fletë. Në fletën nr. 7 me numër rendor 3; në fletën numër 10, me numër rendor 2; në fletën numër 17, me numër rendor 1; në fletën numër 31, me numër rendor 1, 6, 7; në fletën numër 38, me numër rendor 10, 16; në fletën numër 46, me numër rendor 17; në fletën numër 57, me numër rendor 1; në fletën numër 61, me numër rendor 2; në fletën numër 17, me numër rendor 1; në fletën numër 69, me numër rendor 1, 6; në fletën numër 83, me numër rendor 2; në fletën numër 94, me numër rendor 3, 4.
42. **Fotokopje kartelë model 2, nr. 3030**, në ngarkim të **A. T. L.**,
43. **Shkresë e brendshme drejtuar Drejtorisë së Informacionit** me nr. prot. 818/3, datë 25.06.2019 mbi identifikimin, mbledhjen, dorëzimin e dokumentacionit arkivor të kërkuar sipas kërkesës ankimore të paraqitur nga 5 (pesë) punonjës të Ministrisë së Brendshme, me 5 fletë. Niveli i klasifikimit, “sekret”. Afati i ruajtjes, 10 vjet.
44. **Shkresë e brendshme drejtuar Drejtorisë së Informacionit** me nr. prot. 367/4, datë 15.04.2019, mbi zbardhjen e pseudonimeve të bashkëpunëtorëve që figurojnë në dosjen e **A. V. K.** Niveli i klasifikimit, “sekret”. Afati i ruajtjes, 10 vjet.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 16, datë 16.08.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika “b”, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika “a”, “c”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 16, datë 16.08.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. Dosje përpunimi nr. 1329, kategoria 2/B, në ngarkim të **T. H. D.** me 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. Dosje përpunimi nr. 223, kategoria 2/A, në ngarkim të **V. H. D.** me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
3. Dosje përpunimi nr. 1352, kategoria 2/A, në ngarkim të **Sh. K. K.** me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. Dosje përpunimi nr. 875, kategoria 2/B, në ngarkim të **D. A. K.** me 228 (dyqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. Dosje përpunimi nr. 60, kategoria 2/A, në ngarkim **A. M. K.** me 227 (dyqind e njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë (Ana e Sigurimit), dosje përpunimi, kategoria 2/A, nr. 2982, me 42 fletë, në ngarkim të **Xh. R. K.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
7. Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë (Ana e Sigurimit), dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 1733, me 70 fletë, në ngarkim të **R. M. T.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 2235, me 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) fletë, në ngarkim të **F. S. M.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 2450, me 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë, në ngarkim të **N. S. M.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 1036, me 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë, në ngarkim të **B. R. C.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 1152, me 70 (shtatëdhjetë) fletë, në ngarkim të **V. C. K.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
12. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 603 me 40 (dyzet) fletë, në ngarkim të **DH. S. K.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
13. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 1199, me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë, në ngarkim të **N. I. D.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
14. Dosje drejtimi për kërkim nr. 184, me 116 fletë + 1 album me fotografi me 38 fletë + fashikull për agjenturën nr. 184/1, me 24 fletë.

15. Regjistër i objekteve të pajisura me mjete të T. O., nr. 30, datë 13.02.1975 me 30 (tridhjetë) fletë.
16. Regjistër i këshillimeve dhe demaskimeve nr. 4, datë 05.02.1975, 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë.
17. Regjistër përpunimi 2/A dhe 2/B, model 1, me 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
18. Regjistër i përpunimeve nr. 37, 2 volume me 221 (dyqind e njëzet e një) fletë në total, datë 16.10.1980.
19. Dosje me relacione dhe statistika të vitit 1983-1985 të agjencurës, përpunimeve, N/Krimeve dhe të Mesit, 3 volume, me 48 fletë në total.
20. Dosje përpunimi, kategoria 2/A, nr. 499, me 103 (njëqind e tre) fletë, në ngarkim të **B. Xh. K.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
21. Dosje përpunimi, kategoria 2/B, nr. 4171 me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë, në ngarkim të **M. Xh. A.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
22. Fondi Operativ, dosje formulare, kategoria 2/A, nr. 5781, 2 volume me 141 (njëqind e dyzet e një) fletë, në ngarkim të **M. Sh. K.** Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT KORRIK-GUSHT

Fillon dokumentimi vizual i ish-kampeve dhe vendeve të internimit në Myzeqe e Dumre

Kthimi në vende kujtese i kampeve të punës së detyruar

Lushnjë, 10–12 korrik 2019 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të punës për rishqyrtimin e historisë dhe edukimin qytetar, zhvilloi fazën e parë të projektit në fshatrat e Lushnjës, ish-kampe e vende internimi, në vijim të bashkëpunimeve me komunitetet brenda dhe jashtë vendit.

Autoriteti ka zhvilluar aktivitete me në fokus kujtesën që në krijim të tij, duke u përqendruar në specifikat e bashkësisë ku është organizuar veprimtaria, me vëmendje në datat përkujtimore e personalitetet historike, jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin, me bashkëpunime konkrete me komunitetet lokale, si në Shkodër, Tepelenë, Konispol, Pukë, Mirditë, Berat, Korçë e Gjirokastrë.

Bazuar në vendimin e Autoritetit, nr. 422, datë 25.06.2019, për miratimin e aktiviteteve të javës përkujtimore të Tepelenës, 20-30 gusht 2019, z. Simon Mirakaj, Anëtar i Autoritetit dhe znj. Ardita Repishti, Drejtor i Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, të shoqëruar nga fotografi profesionist Gent Onuzi, udhëtuan në fshatrat ish-kampe internimi, në Lushnjë, Fier dhe Elbasan, për dokumentimin e vendeve të vuajtjes së dënimit/ndëshkimit të të internuarve të Tepelenës, të vendosur për dekada me radhë në kampet e vendet e punës të përmendura më lart.

Fotografimi i vendeve ku u vendosën të internuarit e Tepelenës që më pas e shkuan jetën në kampet e punës të ish-ndërmarrjes “29 Nëntori” e më gjerë, në gjendjen në të cilën janë sot, paraprin organizimin e një ekspozite fotografike dhe dokumentare, gjatë përkujtimeve të datave 20-30 gusht “Dinjteti përballë totalitarizmit, Gusht 2019”, në kuadër të aktiviteteve përkujtimore që AIDSSH zhvillon në zonat e Lushnjës, Belshit, Tepelenës dhe Tiranës.

Qindra fotografi të realizuara në fshatrat Çermë kamp, Çermë sektor, Grabian, Gradisht/Ferras, Kryekuq, Karavasta, Bedat, Plug, Savër, Gjază, Rrapëz, Kolonjë, etj., ruhen në arkivin digjital të AIDSSH. Njëherësh, vijon puna me fotot e vjetra të sjella pranë AIDSSH-së nga ish-të internuarit, për realizimin e ekspozitës fotografike, hapi i parë i projektit përkujtimor të kampeve të punës në Lushnjë, që zgjerohet me intervista, dëshmi gojore, kontekstualizim të dhënash, botim të një libri kompleks në dy gjuhë dhe shenjim të vendeve të ndëshkimit, për t’i bërë të njohura e të vizitueshme për të rinjtë dhe të interesuarit.





Dinjiteti përballë totalitarizmit

Lushnjë, Belsh, Tepelenë, Tiranë, 18-30 gusht 2019

“Historitë e patreguara të Lushnjës”

Ekspozitë fotografike dhe arkivore e përndjekjes së Sigurimit në fshatrat e të internuarve në Myzeqe

Lushnjë, 18 gusht 2019 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Bashkinë e Lushnjës, Institutin për Integrimin e të Përndjekurve, Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, të mbijetuar, institucione dhe shoqëri civile aktive hapi në Lushnjë javën përkujtimore “Dinjiteti përballë totalitarizmit, gusht 2019”, organizuar në kuadër të 23 gushtit, Ditës Europiane të Viktimave të Regjimeve Totalitare dhe 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve.

Në orën 10.00, ish-të internuarit dhe trashëgimtarë të tyre, të ardhur nga i gjithë vendi dhe jashtë tij, u takuan pranë memorialit kombëtar të internim-dëbimeve ku, në praninë e përfaqësuesve të Kuvendit, pushtetit lokal dhe institucioneve të sipërpërmendura, u nderua sakrificat dhe dinjiteti njerëzor i atyre mijëra njerëzve që e shkuan jetën në qendra internimi.

Në vijim, në Pallatin e Kulturës “Vaçe Zela”, Lushnjë, u organizua ekspozita fotografike me profile të të internuarve, e titulluar “Historitë e patreguara të Lushnjës” dhe ekspozita me materiale arkivore të AIDSSH mbi persekutimin komunist në këtë zonë, me interesimin e madh të të

pranishmëve dhe ndërveprim mbi materialet e mbledhura e ato që do të shfrytëzohen në vazhdimësi.

Më pas, në sallën e teatrit, ish-të internuarit dhe trashëgimtarët e tyre, qytetarë e të ftuar të tjerë, përfaqësues të pushtetit lokal, institucioneve publike, deputetëve të zonës, trupit diplomatik, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile morën pjesë në prezantimin e projektit të Autoritetit në bashkëpunim me IPP, SHAPP dhe pushtetin lokal, për kthimin në vende kujtese të qendrave të internimit.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të z. Fatos Tushe, kryetar i Bashkisë Lushnjë. Znj. Gentiana Sula, kryetare e AIDSSH, prezantoi projektin e ardhshëm të Autoritetit me komunitetin lokal, kthimi në vende kujtese i shtëpive e ndërtesave simbolike në fshatrat e të internuarve në Lushnjë, Divjakë e Fier, me pllakate përkujtimore që t'i flasin të sotmes dhe t'ua rrëfejnë brezave historitë e patreguara të zonës ku u internua një përqindje e konsiderueshme e kundërshtarëve politikë të sistemit. Vijuan përfaqësues të të përndjekurve, z. Sofokli Kuqeshi, organizator i grumbullimit të përvitshëm të Lushnjës, z. Simon Mirakaj, ish-i internuar në Lushnjë dhe një ndër nismëtarët e idesë për zbardhjen e së shkuarës në zonë; z. Uran Kostreci, ish-i dënuar dhe z. Nebil Çika, përfaqësues i SHAPP, të cilët paraqitën këndështrimet e tyre ndaj projektit dhe mënyrës si t'i qasemi të shkuarës.

Ekspozita fotografike “Historitë e patreguara të Lushnjës”, e bazuar në foto autentike të të internuarve në fshatrat e Lushnjës, Fierit, Divjakës e Elbasanit, dhe gjendjen e tyre sot, 30 vjet pas rënies së regjimit komunist, solli në vëmendje historitë e patreguara të kampeve, profilet e njerëzve dhe vendeve, për të ndërtuar një narrativë gjithëpërfshirëse për to, bazuar në dokumentimin e së djeshmes dhe të sotmes, historitë familjare dhe individuale të të internuarve. Ekspozita qëndroi e hapur deri në fund të muajit gusht.

Ekspozita me materiale arkivore prezantoi dhjetëra dosje të përndjekjes së Sigurimit ndaj faktorit antikomunist në zonën e Lushnjës, shumë prej të cilave, për herë të parë.

Materialet prej disa mijëra faqesh iu vunë në dispozicion të të interesuarve, studiues dhe kërkues shkencorë, ish-të përndjekur dhe familjarë të tyre, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë, dosje përpunimi, hetimore-gjyqësore, regjistra, relacione dhe statistika që kanë të bëjnë me survejimin e elementit “armik” në zonë. Të gjitha materialet e sipërpërmendura janë deklasifikuar. Të interesuarit plotësuan formularët përkatës për t'i lexuar këto dokumente.







Film dokumentar mbi gratë e përndjekura në komunizëm dhe ekspozitë arkivore e përndjekjes së Sigurimit në Dumre

Belsh, 21 gusht 2019 – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Bashkinë e Belshit, Institutin për Integrimin e të Përndjekurve, Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, Kujto.al, të mbijetuar, institucione dhe shoqëri civile aktive vijoi arkivitetet e javës përkujtimore “Dinjteti përballë totalitarizmit, gusht 2019”, në Belsh, organizuar në kuadër të 23 gushtit, Ditës Europiane të Viktimave të Regjimeve Totalitare dhe 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve.

I vendosur në shëtitoren e Belshit, në prani të komunitetit vendas dhe të ftuarve të ardhur nga Tirana, Elbasani e rrethina, takimi u hap nga znj. Gentiana Sula, kryetare e AIDSSH, e cila u shpreh se “detyra jonë qytetare dhe institucionale është hedhja dritë në të shkuarën dhe krijimi i mundësisë që zëri i viktimës të dëgjohet, historitë e tyre të bëhen të njohura dhe të vendosen në kontekstin e kohës kur jetuan, krahas dosjeve që Sigurimi krijoi për ta e për familjet e tyre, që ruajnë qasjen e makinerisë së pushtetit ndaj “armiqve të popullit”.

Ekspozita me materiale arkivore të AIDSSH mbi persekutimin komunist në zonën e Dumresë, me dokumente mbi përndjekjen e ish-të internuarve dhe grave të burgosura politikisht në Kosovë, prezantoi dhjetëra dosje të përndjekjes së Sigurimit ndaj faktorit antikomunist në zonë apo të grave të burgosura, mes të cilave Tefta Tasi, Asamble Hatibi, Laura Keqi, Fatbardha Qorri, Emine Shima, Fatime Dega, Fatime Hoxha, Fatime Reka, Rukije Pame, Xhuljeta Cuka, shumë prej të cilave, për herë të parë.

Materialet prej disa mijëra faqesh u vihen në dispozicion të interesuarve, studiues dhe kërkues shkencorë, ish-të përndjekur dhe familjarë të tyre, shoqëri civile dhe media, duke mundësuar njohjen me inventarët e plotë, dosje përpunimi, hetimore-gjyqësore, regjistra, relacione dhe statistika që kanë të bëjnë meurvejimin e elementit “armik” në zonë, të internuar dhe të burgosur. Të gjitha materialet e sipërpërmendura janë deklasifikuar. Të interesuarit mund të plotësojnë formularët e kërkesës për informim, konform ligjit 45/2015 për t’i lexuar këto dokumente.

Në vijim u shfaq filmi “Gratë midis dhunës dhe stigmës në komunizëm”, i realizuar nga Fiona Todhri dhe Matilda Terpollari, mbi profile të grave të dënuara politikisht gjatë komunizmit, me materiale të vëna në dispozicion nga AIDSSH.

Mes tyre, Tefta Tasi, historia e së cilës rrëfehej nga Lekë Tasi, i vëllai; Nurie Ndreu, e cila tregon kalvarin e vuajtjeve në kërkim të të atit; Fatime Dega, që ndërroi jetë prej pak javësh dhe Taibe Pire, ish-gardiane e burgut të grave në Kosovë, ku vetëm 10 përqind ishin të dënuara politike, të përziera me gratë e tjera të dënuara për krime ordinere.

Aktiviteti vijoi me bashkëbisedim të hapur mbi përndjekjen, demokracinë dhe qasjen tek e vërteta, me një panel ku diskutuan Lekë Tasi, që solli përjetimet personale për komunikimin me të motrën e dënuar dhe fakte e të vërteta mbi persekutorët e saj; Fiona Todhri, pedagoge, realizuese e filmit, e cila u shpreh mbi shtysën për të realizuar një film për gratë në diktaturë; Fatbardh Doko e Liljana Herri, ish-të internuar në fshatin Dragot e në Fierzë të Belshit që sollën përvojat personale të së djeshmes e gjurmës së saj në të sotmen dhe Skënder Vrioni, Sekretar i Përgjithshëm i AIDSSH, i cili bëri një pasqyrë të përndjekjes së Sigurimit në zonë, duke trajtuar materialin arkivor të shfrytëzuar nga Autoriteti për takimin e Belshit, konkretisht dosjet e Tefta Tasit, “Shtriga” mbi Asamble Hatibin dhe dosjen e Fatime Degës, e dënuar në shkelje të rëndë në moshë të mitur.

Bashkëbisedimi vijoi me komente të z. Uran Kostreci, ish-i dënuar politik, z. Nebil Çika i SHAPP dhe përfaqësuesve të komunitetit vendas, që theksuan nevojën për zbardhjen e së vërtetës dhe nderuan vuajtjen fisnike të të pafajshmëve në diktaturë.





Homazhe dhe nderime në ish-kampin e internimit në Tepelenë

Tepelenë, 23 gusht 2019 – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Bashkinë e Tepelenës, Institutin për Integrimin e të Përndjekurve, Shoqatën Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, të mbijetuar, institucione dhe shoqëri civile aktive vijoi arkivitetet e javës përkujtimore “Dinjteti përballë totalitarizmit, gusht 2019”, në Tepelenë, organizuar në kuadër të 23 gushtit, Ditës Europiane të Viktimave të Regjimeve Totalitare dhe 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdokurve.

Si çdo vit, ish-të internuarit, trashëgimtarë të tyre, qytetarë të interesuar, përfaqësues të trupit diplomatik, studentë dhe media u takuan në ish-kampin me tela me gjemba të Tepelenës, për të nderuar sakrificën e të pafajshmëve që vuajtën atje nga 1949-1952, një pjesë e mirë e të cilëve nuk arritën të largoheshin nga kampi dhe u varrosën përreth tij.

Pelegrinazhi në kamp u krye nga disa dhjetëra qytetarë, të shoqëruar edhe nga përfaqësues të klerit, të cilët vendosën lule dhe kurora në kujtim të jetëve të humbura të qindra vetave në Tepelenë, që ende sot rezultojnë të pagjetur.

Dëshmitë tronditëse të dëshmitarëve të vuajtjeve të kampit dhe trashëgimtarëve të tyre u paraqitën në teatrin e qytetit të Tepelenës, me praninë e mediave të shumta.

Po ashtu, u transmetua filmi “Azizi” i gazetares Luljeta Progni, i mundësuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, realizuar mbi dëshmitë e të mbijetuarve të kampit të Tepelenës.

Homazhet në kamp dhe takimi në teatër u përmbyllën me thirrjen institucioneve për kërkimin e të zhdukurve në kamp, mes të cilëve qindra fëmijë, të cilët ende sot vijnë të kërkohen nga familjarët.









30 gushti, Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve me Forcë Ceremoni nderimi në Presidencë

Tiranë, 30 gusht 2019 – Në kuadër të 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i propozoi Presidentit të Republikës vlerësimin me tituj nderi “Për merita të veçanta civile” të personave të përfshirë në trajtimin njerëzor të viktimave të para të kampit të Tepelenës, Fadil dhe Xhuma Petrela, histori zhdukjeje dhe solidariteti e shtrirë në kohë, nga viti 1949 deri në 1993, ku triumfon dinjteti i njerëzve të thjeshtë.

Në vijim të ceremonisë protokollare u shfaq premiera e filmit “Të zhdukurit”, i mbështetur në dëshmi dhe dokumente arkivore mbi të zhdukurit në komunizëm, si bashkëpunim i AIDSSH me Kujto.al, që hedh dritë në të shkuarën dhe kthen vëmendjen në kauzën e mbi 6000 personave që ende sot nuk u gjenden eshtrat. Ceremonia u zhvillua në vazhden e propozimeve të mëhershme të Autoritetit, ku Presidenti i Republikës ka nderuar dinjitetin njerëzor të personave që u përballën pa bujë me sistemin, duke trajtuar njerëzisht familjarët e tyre të zhdukur, më 23 gusht 2018 në kampin e Tepelenës dhe më 25 shkurt 2019, për zbulimin dhe zhvarrimin e 22 intelektualëve të ekzekutuar pa gjyq për “bombën” në legatën sovjetike.

I krijuar në frymën e Rezolutës 1481 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”, (2006), sot, 80 vjet nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore, 75 vjet nga çlirimi i vendit dhe 30 vjet pas rënies së komunizmit, AIDSSH e zhvillon veprimtarinë e vet në respekt të vlerave europiane e propeëndimore, me qasje strategjike që ka në themel të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e tij, lirinë, demokracinë, barazinë para ligjit dhe shtetin e së drejtës.

Kuvendi i Shqipërisë i ka kërkuar Autoritetit që për vitin 2019, e shprehur kjo në Rezolutën përkatëse, midis të tjerave, të përmirësojë punën në drejtim edhe të “vijimit të procesit të informimit, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve, botimeve dhe në veçanti, pjesëmarrjes në media dhe rrjete sociale, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që ato luajnë në drejtim të transparencës dhe sqarimit të opinionit publik”.

Njëherazi në dispozitat e ligjit 45/2015, me qëllim rishqyrtimin historik të ish-Sigurimit të Shtetit dhe edukimit qytetar, Autoriteti mbledh, përpunon, përdor, vë në dispozicion dhe informon mbi dokumente të administruara nga ish-Sigurimi i Shtetit, duke hedhur dritë mbi faktet e vërteta të ndodhura gjatë regjimit diktatorial, duke inkurajuar dialog shoqëror pa komplekse për diktaturën, në emër të së vërtetës, pajtimit, lirisë dhe demokracisë.

Në mbështetje të informimit të publikut u realizua projekti “Dinjiteti përballë totalitarizmit, gusht 2019”, nëpërmjet ekspozimit të dokumenteve arkivore autentike, si materiale mirëfilli të përgatitura nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëbisedime të hapura mbi përndjekjen, demokracinë dhe qasjen tek e vërteta, në Lushnjë, Belsh, e Tepelenë.

Një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi që është fokusuar te të përndjekurit, familjet e tyre dhe shoqatat e të drejtave të njeriut, të rinjtë dhe publiku i gjerë e ka zgjeruar ndjeshëm hartën e veprimtarisë së AIDSSH deri më sot.

Përkujtimi, në përgjithësi ka pasur synim ekspozimin e materialit arkivor të disponuar, në formë digjitale dhe të përpunuar sipas ligjit të të dhënave personale, me pjesëmarrje aktive të historianëve të fushës dhe periudhës, duke bërë bashkë sa më shumë grupe të shoqërisë, përfshirë rininë.

Sa i takon kauzës së të zhdukurve, në dokumentin e Komisionit European të datës 17.04.2018, “Albania 2018 Report”, prioriteti i pestë, Të Drejtat e Njeriut, faqe 26, ka një rekomandim për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit që thotë: “Sa i përket të drejtës për jetën, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pas krijimit të tij në qershor të vitit 2017, miratoi një strategji. Pas një vizite në vend në dhjetor të vitit 2016, Grupi i Punës i OKB-së për personat e zhdukur në mënyrë të detyruar apo vullnetare (WGEID) la disa rekomandime për Shqipërinë, për të trajtuar krimet e kryera gjatë periudhës së diktaturës komuniste. Për shembull, WGEID rekomandoi që Shqipëria të njohë zhdukjet e detyruara të së kaluarës dhe të garantojë mospërsëritjen e tyre, duke gjetur një sistem të përshtatshëm. Gjithashtu,

kërkoi krijimin e një sistemi që ka qasje gjithëpërfshirëse, në vend të masave të copëzuara, për të shuar gjithë paragjykimet që rezultojnë nga represioni i kaluar politik. Numri i njerëzve që janë rrëmbyer ose burgosur fshehurazi gjatë diktaturës mbetet i panjohur, por vlerësohet të jenë rreth 6 000 persona të zhdukur”.

Duke u bazuar në detyrat funksionale që i ngarkon ligji 45/2015, AIDSSH është angazhuar aktivisht dhe ka bashkëpunuar me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe institucionet e tjera publike në vend për personat e humbur, Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë dhe vijon të japë kontributin e vet konkret në sigurimin e informacionit dokumentar të lidhur me ta, po ashtu, në ngritjen e çështjes dhe lobimin me institucione publike e ndërkombëtare për avancim të kërkimeve.

AIDSSH ka bashkëpunuar me Prokurorinë për fillimin e procedurës së gjetjes dhe identifikimit të vendvarrimeve të personave të zhdukur në diktaturë, si dhe me qeverisjen lokale, duke paraqitur propozime konkrete për vendet e kujtesës. AIDSSH ka bërë kërkesë pranë Ministrisë përgjegjëse për përfshirje në projektligjin “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” të një pike ku të përfshihen si vende kujtese dhe vetëdijësimi, vendet e pushkatimit dhe vendvarrimet e fshehta të periudhës së diktaturës komuniste.

Konkretisht, nismat për kthimin në vend kujtese:

-të Kampit të Tepelenës (1949-1951), bazuar në urdhrin nr. 45, datë 6. 6. 2017 për “Ngritjen e grupit të punës për kërkimin e dokumentacionit arkivor për Kampin e Tepelenës dhe krijimin e një memoriali për përkujtimin e datës 30 gusht si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve”.

-dhe të Mënikut (në Pezë), ku u zhvarrosën eshtrat e 22 intelektualëve të pushkatuar pa gjyq më 26 shkurt 1951, vendvarrim masiv i shumë të dënuarve nga diktatura, bazuar në propozimin e Autoritetit për këshillin bashkiak të Tiranës, për kthimin në vend të ndërgjegjes.

Në të dy rastet dhe në të tjera që institucioni po trajton, është ndërtuar partneritet me institucionet publike, qendrore dhe lokale, shoqërinë civile dhe familjarët, për ta kthyer vëmendjen te çështja e të zhdukurve dhe e drejta njerëzore për të vërtetën. Më 4 qershor 2018, Komiteti i ekspertëve të OKB-së miratoi dhe publikoi vërejtjet përmbyllëse, pasi shqyrtoi Raportin e Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës së OKB-së “Për mbrojtjen e të gjithë personave nga Zhdukjet me Forcë”, ku vendi ka aderuar që në vitin 2007 dhe është angazhuar në përmirësimin e kuadrit ligjor për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë zhdukjet me forcë. Në raportimin në Gjenevë u ftua të merrte pjesë AIDSSH, mes institucioneve të tjera të pranishme publike. Zhdukjet me Forcë u parashikuan si vepër penale me ndryshimet në Kodin Penal të miratuara në vitin 2013. Gjatë raportimit u evidentua se janë ndërmarrë një sërë masash për përmirësimin e kuadrit ligjor në përputhje me Konventën, dhe përfaqësuesit e institucioneve informuan mbi masat e ndërmarra për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht të personave të privuar nga liria, të drejtën e viktimës për të njohur të vërtetën, pasojat e zhdukjes me forcë, sigurimin e drejtësisë, hetimin e rasteve dhe sjelljen e shkelësve para drejtësisë, mjetet efektive, kompensimin dhe ruajtjen e memories historike për zhdukjet me forcë të ndodhura gjatë periudhës së komunizmit.

Historikisht, Shqipëria ka pësuar shumë nga ky krim, ku gjatë regjimit komunist një numër i konsiderueshëm qytetarësh janë ekzekutuar, ndërsa të tjerët u zhdukën në rrethana të panjohura. Ndaj, Shqipëria ka ndërmarrë masa konkrete me hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Komisionin Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, në funksion të të cilit, më 30 gusht 2018, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, është bërë prezantimi bashkërisht me

ICMP-në i dy aplikacioneve online që do të ndihmojnë procesin e gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri.

Aplikacionet i ndihmojnë familjarët e personave të zhdukur të raportojnë rastet, si dhe të marrin informacion në lidhje me statusin e rasteve individuale të personave të zhdukur. Treguesi i vendvarrezave iu mundëson përdoruesve që në mënyrë anonime të japin informacion mbi vendndodhjen e varrezave ku mund të gjenden mbetjet njerëzore të personave të zhdukur. Aplikacionet janë publikuar dhe vendosur në faqen zyrtare në AIDSSH-së, për të gjithë të interesuarit.

Deri tani, në adresë të AIDSSH-së janë paraqitur 57 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të zhdukurve. Rezulton se 35 kërkesa janë përfunduar me vendimmarrje të Autoritetit dhe janë në proces verifikimi 22 kërkesa. I gjithë kuadri i mësipërm ligjor dhe veprimtaria e deritanishme e AIDSSH-së është në funksion të mbajtjes gjallë të kujtesës mbi të shkuarën, sepse “nuk mund të ketë të vërtetë pa përkujtimin”, që e shkuara të mos përsëritet dhe shoqëria të ushtrojë të drejtën e vet për t’u njohur me të vërtetën.

Në këtë vazhdë, AIDSSH po përgatit një ekspozitë me të dhëna mbi të personat e humbur dhe zhdukur me forcë, vendvarrimet e raportuara deri më sot dhe profile të zhdukurish, në bashkëpunim me partnerë, ekspozitë që do t’i prezantohet publikut në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.







AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al